



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 3440, datë 27.05 2024

MINISTRIA E FINANCAVE

Nr. 7501/2, datë 11.07 2024

### UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 11, datë 27.05 2024

### PËR

### HAPJEN DHE MBYLLJEN E LLOGARIVE BUXHETORE NË DEGËN E THESARIT TË INSTITUCIONIT ARSIMOR VENDOR, PËRGJEGJËS PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të neneve 12 dhe 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, të nenit 40 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit nr. 148, datë 13.3.2024 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e institucioneve të arsimit special në qendra burimore, si dhe për mënyrën e organizimit e të funksionimit të tyre” dhe vendimit nr. 149, datë 13.3.2024 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve të posaçme dhe procedurave për dhënien e statusit “shkollë me status të veçantë”, Ministri përgjegjës për arsimin dhe Ministri përgjegjës për financat.

### UDHËZOJNË:

#### I. Të përgjithshme

- Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe afateve që duhet të ndiqen në procesin e zbatimit të buxhetit nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimi parauniversitar, në kuadër të përmirësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe të rritjes së transparencës së përdorimit të fondeve publike.
- Institucionet arsimore publike “Shkollë me Status të Veçantë” dhe “Qendrat Burimore” për të ardhurat e krijuara nga vetë institucioni arsimor publik, fondet e arkëtuara nga dhurimet, donacione, grante, sponsorizime nga të tretë, si dhe projekte binjakëzimi, mbajnë llogari buxhetore në degën e thesarit

të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar përkatës, apo llogari bankare pranë bankave të nivelit të dytë.

3. Institucionet arsimore publike parauniversitare për të përmirësuar cilësinë e shërbimit arsimor, përfitojnë fonde publike, grante të brendshme dhe grante të huaja, mbështetje materiale nga dhurues ose sponsorizues, në pajtueshmëri me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim.
4. Institucionet arsimore publike lejohen të sigurojnë të ardhura nga shërbime për të tretët, në përputhje me fushën e veprimtarisë së institucioneve. Të ardhurat që realizohen gjatë vitit ushtrimor do të përdoren sipas legjislacionit buxhetor mbi përdorimin e të ardhurave dytësore.  
Fondet e arkëtuara gjatë vitit ushtrimor nga dhurimet, donacione, grante, sponsorizime nga të tretët, si dhe projekte binjakëzimi do të përdoren në funksion të veprimtarisë arsimore dhe rritjen e cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në arsim në përputhje me planin vjetor të miratuar për institucionin arsimor. Të ardhurat e papërdorura në fund të vitit ushtrimor trashëgohen në vitin pasardhës.
5. Fondet e siguruar nga shërbimet për të tretë përdoren sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Procedurat për arkëtimin, ruajtjen dhe përdorimin e të ardhurave të realizuara nga burime të ligjshme, nga dhurime, donacione, grante, sponsorizime nga të tretët, si dhe projekte binjakëzimi nga realizohen sipas përcaktimeve në këtë udhëzim, si dhe standardeve të përcaktuara në udhëzimin nr. 9, datë 20.3.2018 të ministrit përgjegjës për financat “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar.
6. Hapja dhe mbyllja e llogarive pranë bankave të nivelit të dytë, për institucionet arsimore vendore me status “Shkollë me Status të Veçantë” dhe “Qendrat Burimore”, realizohet sipas procedurave të miratuara në udhëzimin nr. 35, datë 21.9.2020, të ministrit përgjegjës për financat “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, të ndryshuar.

## **II. Procedurat për planifikimin, miratimin dhe administrimin e fondeve buxhetore, fondeve grant, donacione financiare, si dhe ardhurat të krijuara shërbimet me të tretë.**

1. Institucionet arsimore publike “Shkollë me Status të Veçantë”, si dhe “Qendrat Burimore”, për fondet buxhetore, fondeve e përfituara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, fondet e arkëtuara nga dhurimet, donacione, grante të tjera qeveritare, sponsorizime, si dhe të ardhurat të krijuara nga vetë institucioni arsimor publik nga shërbimet me të tretë, i administrojnë në llogarinë buxhetore në degën e thesarit të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar përkatës.
2. Financimi i veçantë nga buxheti i shtetit për institucionet arsimore publike “shkollë me status të veçantë”, si dhe “Qendrat burimore”, planifikohet me formulën “për nxënës”, sipas treguesve të veçantë të niveleve arsimore dhe kushteve që do të sigurojnë IAPP-ja.
3. Institucioni arsimor publik arkëton të ardhura financiare dhe/ose mbështetje materiale në bazë të vullnetit të lirë që ofrohet nga personat fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor.
4. Dhurimet, sponsorizimet në formë monetare apo materiale (pajisje, libra biblioteke, pajisje elektronike, pajisje mobilierie apo asete të tjera në natyrë), të cilat kanë vlerë përdorimi të shtuar në institucionet arsimore publike mbahen në një regjistër të veçantë, i emërtuar “Regjistri i

administrimit të kontributeve financiare, sponsorizimeve e dhurimeve monetare e materiale nga të tretë”.

5. Pranimi i dhurimit, sponsorizimit i të ardhurave financiare dhe/ose mbështetjes materiale, bëhet në marrëveshje në formë të shkruar ndërmjet palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Regjistri i administrimit të kontributeve financiare, sponsorizimeve e dhurimeve monetare e materiale nga të tretë, përmban të gjitha të dhënat e subjektit dhurues, si dhe të dhëna të detajuara për sasinë dhe vlerën e materialeve apo pajisjeve të dhuruara dhe në rastet kur është e mundur, duhet të përmbajë çmimin për njësi dhe specifikimet teknike të tyre.
7. Për ndjekjen e procesit të pranimi të dhurimit, sponsorizimit të të ardhurave financiare dhe/ose mbështetjes materiale, institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimit parauniversitar ngre një komision *ad-hoc* të marrjes në dorëzim të dhurimeve, sponsorizimeve, të mbështetjes materiale, sipas përcaktimeve të udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 të ministrit përgjegjës për financat “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar.
8. Komisioni mban një akt-pranimi për dorëzimin e kontributeve financiare, sponsorizimeve e dhurimeve monetare e materiale nga të tretë, që nënshkruhet nga komisioni dhe përfaqësuesi i subjektit përkatës.
9. Lista me materiale, pajisje, libra biblioteke, pajisje elektronike, pajisje mobilierie apo asetë të tjera në natyrë, përcillen/dërgohen për inventarizim pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimit parauniversitar.

### III. Llogaritë bankare të nivelit të dytë dhe arkëtimi i të ardhurave financiare

1. Të ardhurat, nga kontributet financiare që përfitojnë institucionet arsimore nga dhurimet sponsorizimet, projekte binjakëzimi, grante dhe financime të tjera nga projekte ndërkombëtare në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi, arkëtohen dhe përdoren 100% për nevoja të institucionit arsimor.
2. Të ardhurat e siguruara nga dhuruesit, sponsorizimet, projekte binjakëzimi nga organizata institucione qeveritare e jo qeveritare, donatorë të tjerë vendas dhe të huaj, si financime të drejtpërdrejta nga biznesi, arkëtohen në llogarinë e thesarit apo drejtpërdrejt në llogaritë bankare të çelura në bankat e nivelit të dytë në emër të institucionit arsimor.
3. Fondet e të ardhurave të arkëtuara sipas pikës 2 të kreut III, përfshihen në regjistrat kontabël sipas standardeve të përcaktuara në udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 të ministrit përgjegjës për financat “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të ndryshuar,
4. Institucionet arsimore me status “Shkollë me Status të Veçantë” dhe “Qendrat burimore” hapin llogari buxhetore pranë një banke të nivelit të dytë, sipas procedurave të miratuara në udhëzimin nr. 35, datë 21.9.2020, të ministrit përgjegjës për financat “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, të ndryshuar.
5. Fondet që janë gjendje në llogaritë bankare, pranë bankave të nivelit të dytë, në emër të institucioneve arsimore, transferohen në llogarinë bankare të institucionit të miratuar me këtë udhëzim.
6. Procedurat e blerjes së materialeve apo shërbimeve me të ardhurat e siguruara nga kontributet financiare që përfitojnë institucionet arsimore nga dhurimet, sponsorizimet, projekte binjakëzimi,

apo financime nga projekte ndërkombëtare, realizohen me procedura prokurimi ose sipas parashikimeve ne marrëveshjet specifike me donatorët.

#### IV. Procedurat për menaxhimin financiar dhe kontrollin

1. Drejtori i institucionit arsimor është personi i autorizuar për administrimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore, fondeve e përfituara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, fondet e arkëtuara nga dhurimet, donacione, grante të tjera qeveritare, sponsorizime, si dhe të ardhurat të krijuara nga vetë institucioni arsimor publik nga shërbimet me të tretë. Nëpunësi zbatues është përgjegjës për zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
2. Veprimet në llogarinë bankare në bankat e nivelit të dytë, do të autorizohen me nënshkrimin e të dy personave që administrojnë llogarinë bankare në bankën e nivelit të dytë.
3. Dokumentacioni për fondet e dhuruara në emër të institucionit arsimor nga dhurimet, sponsorizimet, nga persona fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, ruhet në institucionin arsimor për një periudhë prej jo më pak se pesë vjet.
4. Drejtori i institucionit arsimor, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues raportojnë pranë zyrave vendore arsimore parauniversitare dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, për fondet e siguruar si dhe blerjet e materialeve dhe shërbimeve të realizuara nga institucioni arsimor, në fund të periudhës 4-mujore, 8-mujore dhe vjetore.
5. Drejtuesit e institucioneve arsimore, në fund të vitit ushtrimor, hartojnë pasqyrat financiare vjetore, të institucionit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga ministri përgjegjës për financat. Pasqyrat financiare vjetore dorëzohen pranë zyrës arsimore respektive brenda muajit Mars.
6. Për kontrollin dhe auditimin e procedurave të realizuara, dokumentacioni vjetor për arkëtimin, ruajtjen dhe përdorimin e të ardhurave të realizuara nga institucioni et arsimore/ shkollat e arsimit parauniversitar, ruhet në institucion në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga ministri përgjegjës për financat.

#### V. Dispozita të fundit

1. Udhëzimi nr. 29, datë 25.09.2007 i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës “Për grumbullimin, ruajtjen dhe përdorimin e të ardhurave nga dhurimet nga prindërit e nxënësve të shkollave të arsimit parauniversitar”, shfuqizohet.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore Arsimore, si dhe institucioneve arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

OGERTA MANASTIRLIU



MINISTRI I FINANCAVE

ERVIN HETE

